



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 26.5.2015, në orën 9:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Donika Kadaj-Bujupi dhe Milena Miliçević.

Munguan: Doruntinë Maloku dhe Fatmir Limaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Valdete Daka-KGJK, Besim Kelmendi-PSRK, Blerta Bejtullahu dhe Behlul Zeka-EUSR/EU Office, Alma Tafarshiku-EULEX, Valdet Hajdini-IKD, Dren Doli dhe Fisnik Korenica-GLPS, Visar Sutaj-KDI, Baki Gimolli-MD, Edita Kusari-EROL/USAID, Mark Hovon dhe, Albert Avdiu- KGJK, Lekë Batalli-GLPS, Etleva Ikonja-Kosova Sot, Fitore Hajdini dhe Floriana Merovci –ZPRK, Valmire Hoti – Infodirekt. TV, Beadin Sylja- Kosova Press, Leotrim Berisha- Tribuna Channel, Dibran Istrefi – Klan Kosova, Luljeta Krasniqi, Dardan Rexhepi, Petrit Hysaj dhe Sanija Popovic – OSBE, Lavdim Krasniqi-IGJK, Sami Kurteshi – IAP, Besa Maliqi – BIRN, Gentiana Dushi, Hamit Mjeku dhe Zahir Çerkini- praktikant në Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për Avokatin e Popullit;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për Përgjimin e Telekomunikimeve;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për Barazi Gjinore;
8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoi që të fillohet me shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit pasi që eksperti z. Besim Kelmendi nuk mund të jetë prezent deri në fund të mbledhjes.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit

Kryetarja filloi me leximin e raportit me amendamente të grupit punues dhe kërkoi që secili që ka vërejtje në ndonjë amendament të kërkojë fjalën dhe të diskutojë. Tek amendamenti, 2 ku thuhet “Në tërë tekstin e Projektligjit fjala “Prokurorin e Shtetit”, zëvendësohet me “ Prokuroria e Shtetit”, kur i referohet institucionit.”, edhe pse ky nocion është kategori kushtetuese në grup punues, ku kanë qenë edhe ekspertët, kemi vendosur që të bëjmë këtë ndryshim pasi kemi vlerësuar si më të drejtë.

Pa ashtu e lexoi amendamentin 7, ku thuhet “Neni 5 i Projektligjit, paragrafi 6, riformulohet si vijon: “6. Në secilën prokurori ndarja e lëndëve bëhet sipas sistemit alfabetik. Këshilli obligohet që në afat prej 3 muajve të nxjerrë rregullore lidhur me ndarjen e lëndëve.”

Për këtë propozim fjalën e kërkoi përfaqësuesi i KGJK-së z. Albert Avdiu i cili tha se jemi në obligim kontraktual me një projekt të Norvegjisë, ku sipas këtij projekti është paraparë që ndarja e lëndëve të bëhet në mënyrë elektronike sipas sistemit të rastësisë, andaj kjo dispozitë siç është propozuar na shkakton probleme dhe e bënë këtë projekt të pa implementueshem dhe kërkoj që në vend të fjalës “ sipas sistemit alfabetik” të jetë “ sipas sistemit të rastësisë”. Ky propozim u përkrah nga anëtarët e Komisionit.

Fisnik Korenica ishte i pajtimit që të merret propozimi i KGJK-së duke i shtuar fjalët “bazuar në kritere objektive”.

Komisioni u pajtua për këtë formulim: “6. Në secilën prokurori ndarja e lëndëve bëhet sipas sistemit të rastësisë, bazuar në kritere objektive. Këshilli obligohet që në afat prej 3 muajve pas hyrjet në fuqi të këtij ligji të nxjerrë rregullore lidhur me ndarjen e lëndëve”.

Në nenin 8 i Projektligjit, që ndryshon nenin 20 të ligjit bazik, kishte propozim nga OSBE-ja, ku përfaqësuesi i saj arsyetoi propozimin duke thënë se kjo ka të bëjë me praktikën që ka ky trajnim dhe e dobëson cilësinë e prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Për këtë propozim u diskutua gjatë nga anëtarët e Komisionit, kishte mendim për dhe kundër, për këtë diskutuan edhe eksperti Besim Kelmendi dhe përfaqësuesi i IGJK-së Lavdim Krasniqi. Kundër propozimit të OSBE-së ishte Albulena Haxhiu dhe arsyetoi se është e pa kuptim që fillimisht të emërohen prokuroret dhe gjyqtaret e pastaj të trajnohen.

Komisioni me 5 vota “për” dhe 3 “kundër” e përkrahu propozimin e OSBE-së dhe u kërkua që ndryshimet që marrin pëlqimin e Komisionit të jetë unike dhe në Projektligje tjera që të ruhet logjika dhe konsistenca.

Kryetarja konstatoi se komisioni me 6 vota “për” dhe 3 “abstenime” nxori këtë:

Rekomandim

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit;
- II. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;
- III. Aneks i procesverbalit janë paraqitur amendamentet e miratuara nga Komisioni.

3. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat

Armend Zemaj e paraqiti arsyetimin e raportit me amendamente dhe filloi me leximin e raportit me amendamente të grupit punues dhe kërkoi që secili që ka vërejtje në ndonjë amendament të kërkoi fjalën dhe të diskutojnë.

Ishte i diskutueshëm propozimi që “Në nenin 12 të Ligjit bazik, pas paragrafit 1.5 shtohet një paragraf i ri si vijon: “1.6. Departamenti Special, i cili është kompetent për të vendosur lidhur me rastet penale për të cilat është kompetente Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.” Komisioni nuk e përkrahu këtë propozim.

Armend Zemaj tha se nuk ka nevojë të përfshihet pasi që kjo i është lënë në kompetencë KGJK-së që të krijojë degë të reja sipas nevojës kur vlerëson që ka numër të madh të lëndëve sipas kërkesës së komunave. Nëse ne kërkojmë që të shtohen degë të reja kjo bëhet obligative edhe nëse nuk ka ngarkesë të madhe të lëndëve.

Agim Aliu tha se ideja pse e kam propozuar degën në Shtime është se Gjykata Themelore në Ferizaj është nga gjykatat që është themeluar së voni dhe pasi përfshin disa rajone dhe ka grumbullim të lëndëve. Shtimja ka një numër të konsiderueshëm të banorëve dhe e shkarkon

gjykatën në Ferizaj, prandaj propozoi që në nenin 3 të Projektligjit, pas nënparagrafit 2.6, shtohet nënparagrafi i ri si vijon: “2.7. dega në Shtime, për Komunën e Shtimes”.

Donika Kadaj-Bujupi e përkrahu propozimin e parafolësit dhe ishte e mendimit që nuk ka ndonjë problem nëse është vlerësuar nga deputeti i asaj zone që të krijohet një degë e re.

Valdete Daka tha se për mua është e pa kuptim dhe nuk e di kush e ka dhënë këtë ide që në ligjin për gjykatat të futet krijimi i degëve, pasi kjo është e rregulluar në atë formë që kur Komuna vlerëson dhe në bashkëpunim me KGJK-në mund të krijojë degë të reja. Kjo e obligon KGJK-në të krijojë këto degë dhe kjo do të ketë kosto shtesë buxhetore edhe me staf administrativ.

Pas diskutimeve, Komisioni e përkrahu propozimin e deputetit Agim Aliu.

Komisioni diskutoi për nenin 7, paragrafi 1.6 të Projektligjit ku thuhet “1.6. të mos jetë i dënuar për veprë penale”. Valdete Daka propozoi që në fund të fjalisë të thuhet “përveç veprave penale të rrezikimit të trafikut”, sepse ky është kriter shumë i rëndë duke eliminuar njerëz për një pakujdesi.

Komisioni pas shumë diskutimeve nuk e përkrahu propozimin e Valdete Dakes.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Rekomandim

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit;
- II. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;
- III. Aneks i procesverbalit janë paraqitur amendamentet e miratuara nga Komisioni.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;

Donika Kadaj-Bujupi, në cilësi të kryesues së grupit punues paraqiti raportin me amendamente ajo tha se tani është më e lehtë të vendoset pasi që amendamentet që i kemi për këtë Projektligj duhet që ta përcjellim të njëjtën logjikë pa rënë ndesh me atë që i kemi përkrahur.

Fisnik Korenica propozoi që në paragrafin 2, të nenit 3, në fund të fjalisë të shtohen fjalët “e cila përdoret në të gjitha dokumentet, vendimet dhe aktgjykimet.”. Ky propozim u përkrah nga Komisioni.

Albert Avdiu, propozoi që në nenin 2 i Projektligjit, paragrafi 3, pas nënparagrafi 1.32 shtohet paragraf i ri si vijon: “1.33. menaxhimin e sistemit qendror të evidencës penale. Procedura dhe rregullat e tjera në lidhje me evidencë penale do të vendosen me rregullore të miratuar nga Këshilli.” Ky propozim u përkrah nga Komisioni.

Albulena Haxhiu tha se me qëllim që të harmonizohet me ligjin për KPK-në, në nenin 3 të projektligjin në paragrafin që e kemi shtuar në fund të fjalisë të thuhet “ Paga e anëtarit nga Oda e Avokatëve, caktohet dhe paguhet nga Oda e Avokatëve. ” Ky propozim u përkrah nga Komisioni.

Komisioni diskutoi për nenin 16, ku Valdete Daka dhe përfaqësuesi nga zyra e BE-së kërkuan që ky nen të hiqet në tërësi. Kundër propozimit që të hiqet neni 16 ishte Albulena Haxhiu e cila kërkoj që mos të veprohet me standarde të dyfishta pasi që ne dje e kaluam propozimin për mbrojtjen gjyqësore në ligjin për Këshillin Prokurorial.

Pas shumë diskutimeve, Komisioni vendosi që neni 16 i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës të hiqet, po ashtu të hiqet edhe neni 18 i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-224 për këshillin prokurorial të Kosovës, që ishte shqyrtuar në mbledhjen e dt. 25.5.2015.

Kryetarja konstatoi se komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Rekomandim

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit;
- II. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;
- III. Aneks i procesverbalit janë paraqitur amendamentet e miratuara nga Komisioni.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Avokatin e Popullit

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Avokatin e Popullit, ku prezent ishte edhe z. Sami Kurteshi. Ajo e ftoi ta marrë fjalën dhe të arsyetojë prezencën në Komision pasi për këtë takim nuk ishte i ftuar dhe nëse ka ndonjë paqartësi në amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional.

Sami Kurteshi tha se tani nuk e dimë se për cilat amendamente bëhet fjalë, pasi që ne i kemi dorëzuar disa amendamente me propozime konkrete në Komisionin FunkSIONAL me qëllimin e bërjes së një ligji sa më të mirë.

Albulena Haxhiu tha se në këtë fazë, si Komision, vlerësojmë vetëm bazën kushtetuese të amendamenteve dhe të Projektligjit dhe nëse nuk ka probleme të kësaj natyre ne nuk mund ta ndalim.

Meqë nuk kishte vërejtje të tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 05/L-19 për Avokatin e Popullit dhe amendamentet e propozuar janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Përgjimin e Telekomunikimeve

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Përgjimin e Telekomunikimeve dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente t'i paraqesin.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji 05/L-30 për Përgjimin e telekomunikimeve dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Barazi Gjinore

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Barazi Gjinore dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente t'i paraqesin.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 05/L-20 për Barazi Gjinore dhe amendamentet e propozuar janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje në Projektligj dhe amendamente t'i paraqesin.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 05/L-21 për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe amendamentet e propozuar janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

9. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu

Aneks – Amendamentet në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e Projektligjit në paragrafët referues, pas fjalës “Ligjit” shtohet fjala “bazik”.

Amendamenti 2

Në tërë tekstin e Projektligjit fjala “**Prokurorin e Shtetit**”, zëvendësohet me “**Prokuroria e Shtetit**”, kur i referent institucionit.

Amendamenti 3

Në nenin 1 të Projektligjit, paragrafi 1.5, në rreshtin e dytë, fjala “instruksione” hiqet dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 4

Në nenin 1 të Projektligjit, në fund të paragrafit 2, shtohen fjalët “Përveç elementeve të përmendura, një vendim i tillë duhet të arsyetojë së paku neglizhencën, paaftësinë profesionale ose konfliktin e interesit të prokurorit/ve që e bëjnë të besueshëm një vendim të tillë”.

Amendamenti 5

Neni 5 i Projektligjit, paragrafi 3, riformulohet si vijon:

“3. Kryeprokurori është përgjegjës dhe për punën e tij i përgjigjet Kryeprokurorit të Shtetit”.

Amendamenti 6

Neni 5 i Projektligjit, në fund të paragrafit 5 shtohen fjalët “Marrja e rastit duhet të bëhet me vendim të arsyetuar”.

Amendamenti 7

Neni 5 i Projektligjit, paragrafi 6 riformulohet si vijon:

“6. Në secilën prokurori ndarja e lëndëve bëhet sipas sistemit të rastësisë, bazuar në kriteret objektive. Këshilli obligohet që në afat prej 3 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrë rregullore lidhur me ndarjen e lëndëve”.

Amendamenti 8

Neni 5 i Projektligjit, paragrafi 7 riformulohet si vijon:

“7. Kryeprokurorit të një prokurorie apo cilitdo prokuror tjetër të ndonjë prokurorie, Kryeprokurori i Shtetit apo prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, i autorizuar nga ai, mund t’u jap udhëzime të detyrueshme me shkrim për punën konkrete”.

7.1 Udhëzime të tilla mund t’u japin prokurorëve në prokuroritë që drejtojnë edhe kryeprokurorët e prokurorive. Udhëzimet e tilla duhet të jenë të arsyetuara dhe nuk duhet të cenojnë pavarësinë funksionale dhe profesionale të prokurorëve, dhe në veçanti, nuk duhet të përmbajnë udhëzime për sa i përket kualifikimit të veprës, metodave të hetimit dhe mbledhjes së provave, si dhe arsyetimit të hetimit dhe aktakuzës.

7.2 Procedurat e brendshme i adresojnë rastet për të cilat do të nxirren udhëzime administrative dhe procedurat e brendshme hartohen për të adresuar situatat kur udhëzimi është ose joligjor ose në kundërshtim me ndërgjegjen e vartësit”.

Renditja e paragrafëve në vazhdim, bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 9

Neni 5 i Projektligjit, pas paragrafit 7, shtohet një paragraf i ri si vijon:

“8. Udhëzimet jepen me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit unik të praktikave dhe legjislacionit”.

Renditja e paragrafëve në vazhdim, bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 10

Neni 5 i Projektligjit, paragrafi 9, pas fjalës “raporte”, shtohet “ me shkrim” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 11

Neni 5 i Projektligjit, paragrafi 10, riformulohet si vijon:

“ 10. Kryeprokurori i Shtetit dhe kryeprokurorët mund të delegojnë disa kompetenca tek vartësit e tyre”.

Renditja e paragrafëve në vazhdim, bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 12

Në nenin 6 të Projektligjit, paragrafi 2, në rreshtin e tretë fjalët ”ose për ndonjë vepër tjetër” , hiqen dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 13

Në nenin 6 të Projektligjit, paragrafi 4.3, pas fjalës “përgjithshëm”, shtohen fjalët “departamenti për të mitur” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Në nenin 6 të Projektligjit, paragrafi 5, pas fjalës “përgjithshëm” , shtohen fjalët “departamenti për të mitur” teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 14

Në nenin 8 të Projektligjit, nënparagrafi 1.2, **hiqet** dhe radhitja e nënparagrafëve në vazhdim , bëhet sipas numrave me radhë.

Në nenin 8 të projektligjit, në nënparagrafin 1.4, pas fjalës “**jurisprudencës**” shtohen fjalët “ **të pranuar sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë**”.

Amendamenti 15

Neni 8 i Projektligjit, që ndryshon nenin 20 të ligjit bazik, paragrafët 1,2 dhe 3, riformulohen si vijon:

Neni 20

Kushtet për prokurorë të shtetit

1. Pas emërimit nga Presidenti i Kosovës, këta prokurorë, me përjashtim të atyre që kanë përvojë paraprake si prokuror, i nënshtrohen trajnimit fillestar që do të organizohet nga Instituti Gjyqësor i Kosovës. Trajnimi fillestar duhet të zgjasë 12 (dymbëdhjetë) muaj, në bazë legjislacionit në fuqi.
2. Gjatë trajnimit fillestar, prokurorëve nuk do t’u caktohen raste.
3. Prokurorët e emëruar do të vlerësohen pas rezultateve të trajnimit fillestar, në bazë të dispozitave relevante të ligjit. Periudha e trajnimit fillestar do të zgjatet për ata prokurorë që dështojnë ta përfundojnë në mënyrë adekuate trajnimin fillestar, siç është përcaktuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës.

Amendamenti 16

Neni 8 i Projektligjit, që riformulon nenin 20 të ligjit bazik, në fund të paragrafëve 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4, të Projektligjit, shtohen fjalët ” si dhe bazuar në vlerësimin e performancës”.

Neni 8 i Projektligjit, që riformulon nenin 20 të ligjit bazik, pas paragrafit 4.2, shtohet paragraf i ri si vijon:

“4.3 për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë Speciale, prokurori duhet të ketë së paku 6 (gjashtë) vite përvojë si prokuror, nga të cilat 4 (katër) vite përvojë si prokuror në Departamentin e Krimeve të Rënda të Prokurorisë Themelore”.

Renditja e paragrafëve në vazhdim, bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 17

Në nenin 10 të Projektligjit, që ndryshon nenin 21 të ligjit bazik, paragrafi 1.11, fjalët “**dhe të drejtat tjera**” hiqen dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 18

Neni 11 i Projektligjit, riformulohet si vijon:

Neni 11

Neni 25 i Ligjit bazik, riformulohet si vijon:

1. Prokurorët kanë të drejtë që me aprovimin e Këshillit, të marrin pjesë në organizata profesionale, takime shkencore, të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të gjyqtarëve.
2. Prokurorët, jashtë orarit të punës, me vendim të Këshillit, mund të angazhohen në veprimtari të cilat janë në përputhje me Kodin e Etikes dhe Sjelljen profesionale të prokurorëve.
3. Në pajtueshmëri me dispozitat e Kodit të Etikës dhe Sjelljes profesionale, prokurorët mund të angazhohen në shkrime profesionale dhe shkencore, por nuk mund të botojnë përmbajtjen relevante të dosjeve prokuroriale gjatë apo pas përfundimit të funksionit prokurorial, përveç nëse kjo lejohet shprehimisht me ligj apo akt nënligjor të lëshuar nga Këshilli.
4. Prokurorët që pranojnë shpërblim për këto aktivitete, nuk mund të tejkalojnë vlerën prej 25% të pagës bazë, për pjesëmarrje në veprimtari të parapara sipas këtij neni dhe për këtë shpërblim e njoftojnë Këshillin.

Amendamenti 19, dy propozime

A. Propozim i Komisionit FunkSIONal

Neni 12 i Projektligjit, riformulohet si vijon:

Neni 12

Pas nenit 32 të Ligjit bazik, shtohet neni i ri 32/A, me tekstin si vijon:

Neni 32/A

Dispozitat kalimtare

1. Gjatë kohëzgjatjes së mandatit të EULEX-it në Kosovë, Kryeprokurori i Shtetit nuk mund të marrë nën juridiksion raste që i janë caktuar një prokurori të EULEX-it, pa pëlqimin e Kryeprokurorit të EULEX-it.

B. Propozim i deputetes Albulena Haxhiut, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 12, paragrafi 1 i Projektligjit, fshihet në tërësi.

Amendamenti 20

Neni 12 i Projektligjit, paragrafi 2, riformulohet si vijon:

“2. Statusi i stafit administrativ i nënshtrohet parimeve të shërbimit civil dhe do të rregullohet me ligj të veçantë”.

Aneks – Amendamentet në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e Projektligjit në paragrafët referues, pas fjalës “ Ligjit” , shtohet fjala “ bazik “.

Neni 1 i projektligjit riformulohet si vijon:

Neni 1

Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6., pas fjalës “Departamentit”, fshihet fjala “të Përgjithshëm”.

Amendamenti 2

Në nenin 3 të Projektligjit, pas nënparagrafit 2.6, shtohet nënparagrafi i ri si vijon:

“2.7. dega në Shtime për Komunën e Shtimes”

Amendamenti 3

Neni 4 i Projektligjit riformulohet si vijon:

Neni 4

Në nenin 13 të ligjit bazik, pas paragrafit 2, shtohet paragrafi i ri si vijon:

“3. në kuadër të Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë, funksionon Divizioni për kontestet lidhur me investitorët e huaj, me juridiksion për tërë territorin e Kosovës. Divizioni i tillë ka kapacitete të mjaftueshme humane dhe gjyqtarë të mjaftueshëm për zgjidhjen e lëndëve.

Amendamenti 4

Pas nenit 4 të Projektligjit, shtohet nen i ri si vijon:

Neni 5

Neni 15, paragrafi 1, nënparagrafi 1.21 i ligjit bazik riformulohet si vijon:

1.21. çfarëdo krimi tjetër i dënueshëm mbi 10 (dhjetë) vite, siç përcaktohet me ligj.”

Renditja e neneve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 5

Në nenin 7 të Projektligjit, nënparagrafi 1.2, **hiqet** dhe radhitja e nënparagrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave më radhë.

Në nenin 7 të projektligjit, në nënparagrafin 1.4, pas fjalës “**jurisprudencës**” shtohen fjalët “ **të pranuar sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë.**”

Amendamenti 6

Neni 8 i projektligjit që ndryshon nenin 27 të ligjit bazik, paragrafët 1,2 dhe 3 riformulohen si vijon:

Neni 27

Kushtet për gjyqtar

1. Pas emërimit nga Presidenti i Kosovës, këta gjyqtarë, me përjashtim të atyre që kanë përvojë paraprake si gjyqtar, do t’i nënshtrohen trajnimit fillestar, i cili do të organizohet nga Instituti Gjyqësor i Kosovës. Trajnimi fillestar do të zgjasë 12 (dymbëdhjetë) muaj, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Gjatë trajnimit fillestarë gjyqtarëve nuk do t’u caktohen raste.
3. Gjyqtarët e emëruar do të vlerësohen pas rezultateve të trajnimit fillestar, në përputhje me dispozitat relevante të këtij ligji. Periudha e trajnimit fillestar do të vazhdohet për ata gjyqtarë që dështojnë të përfundojnë në mënyrë adekuate trajnimin fillestar, siç është përcaktuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës.

Amendamenti 7

Në nenin 10 të Projektligjit, paragrafi 3 që ndryshon nenin 29 të ligjit bazik, fjalët “**dhe të drejtat tjera**” hiqen dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 8

Neni 11 i projektligjit riformulohet si vijon:

Neni 11

Neni 32 i Ligjit bazik riformulohet si vijon:

1. Gjyqtarët kanë të drejtë që me aprovimin e Këshillit të marrin pjesë në organizata profesionale, takime shkencore, të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të gjyqtarëve.
2. Gjyqtarët, jashtë orarit të punës, me vendim të Këshillit mund të angazhohen në veprimtari të cilat janë në përputhje me Kodin e Etikës dhe sjelljen profesionale të gjyqtarëve
3. Në pajtueshmëri me dispozitat e Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale të gjyqtarëve, gjyqtarët mund të angazhohen në shkrime profesionale dhe shkencore, por nuk mund të botojnë

përmbajtjen relevante të dosjeve gjyqësore gjatë apo pas përfundimit të funksionit gjyqësor, përveç nëse kjo lejohet shprehimisht me ligj apo akt nënligjor të lëshuar nga Këshilli.

4. Gjyqtaret që pranojnë shpërblim për këto aktivitete, nuk mund të tejkalojnë vlerën prej 25% të pagës bazë, për pjesëmarrje në veprimtaritë e parapara sipas këtij neni dhe për këtë shpërblim e njoftojnë Këshillin.

Amendamenti 9

Neni 13 i Projektligjit hiqet.

Amendamenti 10

Neni 14 i Projektligjit riformulohet si vijon:

Pas nenit 42 të ligjit bazik shtohet neni i ri 42/A, me tekstin si në vijim:

Statusi i stafit administrativ i nënshtrohet parimeve të shërbimit civil dhe do të rregullohet me ligj të veçantë.

Amendamenti 11

Neni 15 Projektligjit riformulohet si vijon:

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Aneks – Amendamentet në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e Projektligjit në paragrafët referues, pas fjalës “ Ligjit” shtohet fjala “ bazik “.

Amendamenti 2

Neni 1 i Projektligjit riformulohet si vijon:

Pas nenit 3 të ligjit bazik, shtohet nen i ri 3/A me tekstin si vijon:

“Neni 3/A

Statusi dhe stema

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (në tekstin e mëtejme: Këshilli) gëzon subjektivitet juridik.
2. Këshilli dhe gjykatat kanë stemën sipas ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës, e cila përdoret në të gjitha dokumentet, vendimet dhe aktgjykimet.

Amendamenti 3

Neni 2 i Projektligjit, paragrafi 3, pas nën paragrafi 1.32 shtohet paragraf i ri si vijon:

“1.33. menaxhimin e sistemit qendror të evidencës penale. Procedura dhe rregullat e tjera në lidhje me evidencë penale do të vendosen me rregullore të miratuar nga Këshilli.”

Renditja e nën paragrafëve të tjerë bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 4

Neni 3, paragrafi 3, i Projektligjit riformulohet si vijon:

Neni 5, paragrafi 3, i ligjit bazik fshihet.

Pas nenit 5 të ligjit bazik shtohet nen i ri 5A si vijon:

Neni 5 A

Procedura e propozimit, zgjedhjes dhe e shkarkimit të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor që zgjidhën nga Kuvendi

1. Procedura për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga Kuvendi, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 2,3 dhe 4 i Kushtetutës, fillon 6 (gjashtë) muaj para skadimit të mandatit të anëtarit.

2. Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kur mandati përfundon para kohe, siç përcaktohet me këtë ligj, procedura për zgjedhjen e anëtarit fillon brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e mbetjes së vendit të lirë.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës e shpall konkursin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit në media të shkruara dhe elektronike.
4. Komisioni përkatës i Kuvendit përcakton kriteret e konkursit për zgjedhjen e anëtarit. Afati i kohëzgjatjes së konkursit nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 (pesëmbëdhjetë), e as më i gjatë se 20 (njëzet) ditë.
5. Pas skadimit të afatit të paraparë në paragrafin 4 të këtij neni, Komisioni përkatës i Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, vlerëson nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur anëtarë të këshillit, dhe hedh poshtë kandidaturat që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në konkurs.
6. Komisioni zhvillon intervistë me secilin kandidat i cili plotëson kushtet për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit dhe në bazë të të dhënave të paraqitura dhe rezultateve të intervistës, përgatitë listën e ngushtë të kandidatëve.
7. Lista për mbledhjen e Kuvendit përmban 2 (dy) kandidatë për një pozitë.
8. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votim të fshehtë zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor.
9. Nëse në rrethin parë kandidatët e propozuar nga Komisioni përkatës i Kuvendit nuk marrin shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, atëherë në raundin e dytë konsiderohet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave.
10. Anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi shkarkohen nga detyra në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me propozim të Këshillit.

Amendamenti 5

Neni 3 i Projektligjit, paragrafi 7 në fund, pas fjalës “ **kompensimit**” shtohen fjalët “ **përkatësisht pagën** “

Amendamenti 6

Në nenin 3 të Projektligjit, pas paragrafit 7, shtohen paragrafët e ri si vijon:

“ 8. Kryetarët e Gjykatave dhe kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës”.

“9. Anëtari i Këshillit që vjen nga Oda e Avokatëve nuk mund të ushtojë detyrën e avokatit derisa është anëtar i Këshillit. Paga e anëtarit nga Oda e Avokatëve, caktohet dhe paguhet nga Oda e Avokatëve. ”

Amendamenti 7

Neni 7 i Projektligjit, në rreshtin e dytë fjala “**individuale**” dhe zëvendësohet me “**penale**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 8

Neni 9 i Projektligjit riformulohet si vijon:

“Neni 9

1. Në nenin 19 të Ligjit bazik, paragrafi 4, pas fjalëve “me shkrim”, shtohet fjala “në Këshill”.

2. Në nenin 19 të Ligjit bazik, pas paragrafit 4, shtohen paragrafët e ri si në vijim:

“5. Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve me mandat fillestar bëhet së paku dy herë gjatë këtij mandati nga Komisioni për vlerësim të performancës së gjyqtarëve, një herë pas trajnimit fillestar dhe një herë në fund të mandatit fillestar. Kriteret për vlerësim gjatë mandatit fillestar do të specifikohen në një rregullore të nxjerrë nga Këshilli.

6. Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve me mandat të përhershëm bëhet çdo 3 (tre) vjet, në mënyrën e tillë që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji Këshilli cakton me short 1/3 e gjyqtarëve, brenda secilës gjykatë, si grupin e parë të cilët do t’u nënshtrohen vlerësimit të performancës në afat prej 3 muajsh. I njëjti short mbahet pas 1 viti për t’ i caktuar gjyqtarët që do bëjnë pjesë në grupin e dytë, dhe grupin e tretë pas dy viteve respektivisht.”

Amendamenti 9

Neni 10, në paragrafin 3, në fund të fjalisë shtohen fjalët “Vlerësimi i tillë duhet të bazohet në kriteret objektive, të matshme dhe tërësisht transparente. Objektiviteti i një vlerësimi të tillë duhet të reflektojë metoda të çmuara të nivelit të praktikave ndërkombëtare, dhe të cilat janë shkajshmërisht të arsyetuara dhe transparente.”

Neni 10, paragrafin 5 në rreshtin e tretë pas fjalës “**rregullohet me**” shtohet “**këtë**”, dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 10

Neni 14 i Projektligjit, në rreshtin e pestë fjalët “ **5 (pesë)**” hiqen dhe zëvendësohen me “**2 (dy)**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 11

Pas nenit 14 të Projektligjit shtohet paragraf i ri si vijon:

“6. Në rastin kur Zyra e Prokurorit Disiplinor ka lejuar parashkrimin e lëndës, ose shtyrjen e dërgimit të saj në gjykim të Komisioni Disiplinor, gjë e cila rezulton ta pamundësojë këtë të fundit për ta shqyrtuar atë sipas këtij ligji, Komisioni detyrohet ta njoftojë Këshillin Gjyqësor për një lëshim të tillë të zyrës së Prokurorit Disiplinor. Mbi një lëshim të tillë këshilli kërkon përgjegjësi zyrtare nga zyra e prokurorit disiplinor dhe nëse për një gjë të tillë nuk merret përgjigje e arsyetuar, një lëndë të tillë detyrueshëm ja adreson Prokurorit të Shtetit për hetim eventual të keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga Zyra e Prokurorit Disiplinor.”

Amendamenti 12

Në nenin 15 të Projektligjit riformulohet si vijon:

Neni 15

1. Në nenin 39 të Ligjit bazik, pas paragrafit 4, shtohet paragraf i ri si vijon:

“5. Këshilli gjatë vendosjes për ankesë mund të refuzojë ankesën, të vërtetojë ose të ndryshojë vendimin ose ta prishë dhe ta kthej në rishqyrtim Komisionit Disiplinor.

Amendamenti 13

Në nenin 15 të Projektligjit pas paragrafit 5 shtohet paragraf i ri si vijon:

“6. Vendimi i tillë i Këshillit duhet të jetë i arsyetuar sa i takon provave të administruara nga të dyja palët, interpretimit të shkeljeve të pretenduara, dhe masës së dënimit të argumentuar që do t'i përshtatej arritjes së qëllimit të përcaktuar me këtë ligj. Në një rast të tillë, vendimi i Këshillit duhet të reflektojë, dhe të arsyetojë, zbatimin e parimit të proporcionalitetit në vendosjen për çështjen e tillë. Një vendim i tillë bëhet transparent sipas kushtëzimeve të ligjit mbi të dhënat personale të Republikës së Kosovës.”

Amendamenti 14

Neni 16 i Projektligjit, hiqet dhe renditja e neneve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.